



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR REGJISTRIM DHE KALIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 30.07.2026



PËRMBAJTJA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	4
NENI 1 - QËLLIMI	4
NENI 2 - ORGANET KOMPETENTE	4
NENI 3 - PËRKUFIZIMET	5
II. REGJISTRIMI DHE EVIDENCA E KLUBEVE	6
NENI 4 - KËRKESA PËR REGJISTRIM	6
NENI 5 - VENDIMI PËR REGJISTRIM	8
NENI 6 - NJOFTIMI PËR NDRYSHIME	8
NENI 7 - PJESËMARRJA NË GARA	8
NENI 8 - NDËRRIMET STATUTARE TË KLUBEVE	8
NENI 9 - SHUARJA E ANËTARËSISË	9
NENI 10 - FSHIRJA NGA ANËTARËSIA	10
NENI 11 - REGJISTRI I KLUBEVE ANËTARE TË FBK-SË	10
III. FUZIONIMI (BASHKIMI) I KLUBEVE	10
NENI 12 - FUZIONIMI	10
IV. REGJISTRIMI I LOJTARËVE	11
NENI 13 - PARIMET THEMELORE	11
NENI 14 - REGJISTRIMI	12
NENI 15 - KËRKESA PËR REGJISTRIM TË LOJTARËVE	13
NENI 16 - PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E LOJTARIT NDËRKOMBËTAR (TË HUAJ)	16
V. PERIUDHA(T) KALIMTARE DHE KALIMI/TRANSFERI NGA KLUBI NË KLUB	17
NENI 17 - AFATET PËR KALIM	17
NENI 18 - RASTET KUR LEJOHET KALIMI/TRANSFERI	17
NENI 19 - TRANSFERIMI I LOJTARËVE TEK GJENERATAT E REJA	18
NENI 20 - KOMPENSIMI/DËMSHPËRBLIMI	18
NENI 21 - PROCEDURA PËR KALIM/TRANSFER PREJ KLUBIT NË KLUB	19
VI. E DREJTA PËR LOJË - LICENCA	20
NENI 22 - LICENCA	20
VII. MARRËVESHJA/KONTRATA MES KLUBIT DHE LOJTARIT	20
NENI 23 - MARRËVESHJA NDËRMJET KLUBIT DHE LOJTARIT	20
VIII. PARAQITJA JASHTË SHTETIT	22
NENI 24 - E DREJTA E PARAQITJES JASHTË SHTETIT	22
NENI 25 - KËRKESA	22
NENI 26 - TRANSFERI NDËRKOMBËTAR I LOJTARËVE	23
X. PARAQITJA E LOJTARËVE NDËRKOMBËTARË (TË HUAJ)	23
NENI 27 - PARAQITJA E LOJTARËVE TË HUAJ	23
NENI 28 - LOJTARI I NATYRALIZUAR	23
XI. LICENCA E DYFISHTË DHE HUAZIMI	24
NENI 29 - LICENCA E DYFISHTË	24
NENI 30 - HUAZIMI I LOJTARËVE	25
XII. MEKANIZMAT LIGJOR BRENDË FEDERATËS	26
NENI 31 - PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË LOJTARIT TË LIRË	26



NENI 32 – PROCEDURA PËR MBROJTJE TË KONTRATËS	27
NENI 33 – PROCEDURA PËR ZGJIDHJEN E MOS-MARRËVESHJEVE MES KLUBEVE	27
NENI 34 – ANKESA NË VENDIMET E KOMISIONIT TË GARAVE.....	28
XIII. DORËZIMI	29
NENI 35.....	29
XIV. AFATET	29
NENI 36.....	29
XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALUESE	30
NENI 37.....	30



Në bazë të nenit 24, alinea 1.18 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.07.2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR REGJISTRIM DHE KALIM E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NENI 1 - Qëllimi

- 1.** Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për:
 - 1.1.** regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve;
 - 1.2.** marrëdhëniet kontraktuale;
 - 1.3.** kalimin dhe huazimin e lojtarëve;
 - 1.4.** licencimin e lojtarëve dhe të drejtën e paraqitjes;
 - 1.5.** mbrojtjen e kontratës;
 - 1.6.** statusin e lojtarit të lirë;
 - 1.7.** zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
 - 1.8.** dispozitat përfundimtare dhe kalimtare.

NENI 2 - Organet Kompetente

- 1.** Procedurat në përputhje me këtë Rregullore zhvillohen në dy kategori:
 - 1.1.** procedurat administrative/sportive;
 - 1.2.** procedurat kontraktuale dhe të statusit të lojtarëve.
- 2.** Komisioni i Garave është organ kompetent në shkallë të parë për çështje administrative dhe sportive.
- 3.** Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit (KAA) është:
 - 3.1.** organ i shkallës së dytë për vendimet e Komisionit të Garave; dhe
 - 3.2.** organ kompetent në shkallë të parë dhe përfundimtare për mosmarrëveshjet kontraktuale dhe të statusit të lojtarëve, gjegjësisht për procedurat për përcaktimin e statusit të lojtarit të lirë, mbrojtjen e kontratës, mosmarrëveshje klub-lojtar, mosmarrëveshje klub-klub (financiare/transfer).
- 4.** Vendimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit janë përfundimtare brenda FBK-së dhe nuk i nënshtrohen ankesës në organet e tjera të Federatës.



NENI 3 - Përkufizimet

1. Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë rregullore do të interpretohen për të përfshirë të gjitha gjinitë, dhe asnjë dispozitë nuk do të interpretohet si specifike për gjininë përveç nëse shprehet qartë ndryshe.

2. Lojtari - anëtar i regjistruar i klubit;

a. Termi **lojtar profesionist** do të thotë një lojtar i regjistruar i cili ka një kontratë profesionale për zhvillimin e veprimtarisë sportive, profesioni kryesor i të cilit është të luajë basketboll dhe i cili është i siguruar detyrimisht mbi këtë bazë.

b. Të gjithë lojtarët e tjerë kanë **status amator**.

3. Lojtar i huaj - lojtar që nuk ka shtetësinë e Republikës së Kosovës në momentin e regjistrimit në FBK;

4. Lojtar i lirë (free agent) - konsiderohet vetëm nëse:

a. nuk ka kontratë valide me asnjë klub për edicionin garues përkatës; ose

b. ka fituar statusin e lojtarit të lirë me vendim të Komisionit të Arbitrazhit për Ankesat (KAA).

Lojtari i lirë ka të drejtë të nënshkruajë kontratë me çdo klub tjetër, pa kufizime nga klubi i mëparshëm, deri në përfundimin e afatit kalimtar dimëror.

5. Klub sportiv/ i basketbollit - person juridik i cili zhvillon veprimtarinë sportive të trajnimit sportiv dhe pjesëmarrjes në garë sportive të basketbollit. Klubi regjistrohet dhe vepron si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare (me përgjegjësi të kufizuara ose shoqëri aksionare), në përputhje me ligjet përkatëse. Një klub nuk mund të ketë statusin e organizatës joqeveritare dhe të shoqërisë tregtare njëkohësisht. Për të marrë pjesë në garat e basketbollit, klubi regjistrohet në FBK.

a. Klub profesional basketbolli - i referohet vetëm një klubi të Superligës, pa marrë parasysh formën juridike të klubit, dhe që ka lidhur kontratë profesionale loje me më shumë se gjysmën e lojtarëve të licencuar të ekipit të të rriturve me të drejtë loje për sezonin aktual të garave. Klubet profesionale basketbolli janë të detyruara të përmbushin detyrimet e parashikuara me Ligjin për Sportin.

6. Shkolla e basketbollit - person juridik që zhvillon veprimtarinë sportive të trajnimit ose dhënies së instruksioneve sportive për basketbollistët nën



moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Shkolla e basketbollit regjistrohet dhe vepron si shoqëri tregtare në përputhje me ligjin përkatës. Kjo nuk përfshin shkollat e basketbollit që funksionojnë në kuadër të klubeve sportive / të basketbollit.

7. Regjistrimi - Regjistrimi i lojtarit është procedura administrative me të cilën një lojtar evidentohet në regjistrin zyrtar të FBK, si anëtar i një klubi të caktuar. Regjistrimi nuk krijon të drejtë automatike për pjesëmarrje/lojë në ndeshje zyrtare, por përfaqëson vetëm evidencim administrativ të statusit të lojtarit në sistemin e FBK-së.

8. E drejta për lojë (licenca) - e drejta për lojë (në tekstin e mëtejshme: licenca) është akti zyrtar me të cilin lojtarit i lejohet pjesëmarrja në ndeshje zyrtare të organizuara nga FBK, përkatësisht në kampionat dhe në Kupë.

9. Huazimi i lojtarëve - instrument që lejon një lojtar të marrë të drejtën për të luajtur për ekipin e një klubi tjetër për një kohë të caktuar.

II. REGJISTRIMI DHE EVIDENCA E KLUBEVE

NENI 4 - Kërkesa për regjistrim

1. Ekipi apo shkolla e cili shpreh dëshirën që të bëhet anëtar i FBK-së, kërkesën për regjistrim ia paraqet Komisionit të Garave, kërkesë e cila duhet miratuar përkohësisht nga Bordi i FBK-së deri në pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në Kuvendin e Federatës në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.

2. Anëtarësia e klubeve në Federatë sigurohet pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të anëtarësimit nga ana e subjektit që aplikon për regjistrim, të cilat janë të përcaktuara në vijim:

2.1. regjistrimi i subjektit si organizatë joqeveritare apo shoqëri tregtare, në përputhje me ligjet përkatëse;

2.2. statuti dhe aktet tjera normative për themelimin e klubit sportiv të miratuara;

2.3. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës;

2.4. vendimi i komunës me të cilin dëshmohet selia e klubit ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;



2.5. posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të klubit, që vërtetohet nga menaxheri i infrastrukturës përkatëse;

2.6. lista e sportistëve që janë pjesë e klubit dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Sport;

2.7. formulari për regjistrim i firmosur nga personi i autorizuar dhe vulosur me vulën e subjektit dhe dokumentet përcjellëse.

3. Anëtarësia e shkollave të basketbollit sigurohet pas plotësimit të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të anëtarësimit nga ana e subjektit që aplikon për regjistrim, të cilat janë të përcaktuara në vijim:

3.1. regjistrimi i subjektit si shoqëri tregtare, në përputhje me ligjin përkatës;

3.2. statuti dhe aktet tjera normative për themelimin, të miratuara;

3.3. vendimi i komunës me të cilin dëshmohet selia e shkollës ku ushtron veprimtarinë sportive bazë të tij;

3.4. strukturat qeverisëse të themeluara dhe personat që angazhohen në organet drejtuese të mos e kenë të ndaluar të ushtrojnë këtë veprimtari sipas ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës;

3.5. posedimi i infrastrukturës optimale për ushtrimin e veprimtarisë sportive të shkollës, që vërtetohet nga menaxheri i infrastrukturës përkatëse;

3.6. lista e sportistëve që janë pjesë e shkollës dhe trajnerin e angazhuar që plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për Sport;

3.7. dokumentet përcjellëse të nevojshme sipas rregulloreve përkatëse të Federatës.

4. Me paraqitjen e kërkesës për regjistrim në FBK, klubi apo shkolla obligohet që të respektojë Statutin, Rregulloret dhe aktet tjera normative të organeve dhe organizatave të Federatës së Basketbollit të Kosovës, FIBA Europe, FIBA, WADA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar;

5. Klubet dhe shkollat janë materialisht dhe penalisht përgjegjës për saktësinë e të dhënave që paraqesin pranë organeve të FBK-së.



NENI 5 - Vendimi për regjistrim

- 1.** Komisioni i Garave është i obliguar që në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të kërkesës për regjistrim, të shqyrtojë të njëjtën dhe 24 orë para skadimit të marrë vendim për regjistrimin e ekipit si anëtar të FBK-së.
- 2.** Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni i Garave e përcjell aplikim tek Bordi për miratim të përkohshëm, deri në pranimin përfundimtar të anëtarëve të rinj në Kuvendin e Federatës në mbledhjen e radhës, me më tepër se 50% të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
- 3.** Aktvendimi për regjistrim i dorëzohet ekipit, i cili regjistrohet si anëtar i FBK-së në regjistrin përkatës.
- 4.** Nëse kërkesa për regjistrim nuk i përmban të gjitha parakushtet e cekura në këtë nen, nuk është i bashkangjitur aktvendimi regjistrimit në Qendrën regjistruese dhe nuk është firmosur dhe vulosur me vulë, Komisioni i Garave 24 orë para skadimit të afatit për paraqitje në garat e FBK-së do të marrë aktvendim për refuzimin e kërkesës si e parregullt.

NENI 6 - Njoftimi për ndryshime

- 1.** Çdo klub anëtar i FBK duhet të njoftojë zyrën ekzekutive të FBK-së brenda 15 ditëve nga pranimi i ndryshimeve në lidhje me dokumentacionin e klubit.
- 2.** Të gjitha ndryshimet futen në regjistrin bazë të anëtarëve.

NENI 7 - Pjesëmarrja në gara

- 1.** Pas regjistrimit të klubit në FBK, i njëjti është i obliguar që të kyçet në fillim të garave të edicionit të ri dhe organi i autorizuar i FBK-së është i obliguar që t'ia mundësojë.
- 2.** Nëse ekipi nuk kyçet nga fillimi i edicionit në ndeshjen e parë, Komisioni i Garave i FBK-së sipas detyrës zyrtare do të marrë aktvendim mbi fshirjen e ekipit nga anëtarësimi në FBK.

NENI 8 - Ndërrimet statutare të klubeve

- 1.** Në rast të ndërrimeve statutare të klubeve në institucionet e Republikës së Kosovës, apo në rast të së drejtës për të garuar në nivel të caktuar të garave, si dhe në rastin e fuzionimit (bashkimit) të dy apo më tepër skuadrave, Komisioni i Garave në kërkesë të ekipeve do të lëshon pëlqimin në formë të shkruar, vetëm atëherë nëse kërkesës i bashkëngjiten deklaratat për marrjen e të gjitha të drejtave dhe obligimeve nga ekipet të cilat



kërkojnë pëlqimin apo marrëveshjet reciproke se cili ekip do t'i marrë mbi sipër të drejtat për garim dhe detyrimet.

2. Deklarata dhe marrëveshja e detyrimeve duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga personat e autorizuar të të gjitha ekipeve të cekura në deklaratë apo marrëveshje.

NENI 9 - Shuarja e anëtarësisë

1. Statusi i anëtarit përfundon në rast të dorëheqjes, përjashtimit, apo shkrirjes së anëtarit, siç specifikohet në vazhdim:

1.1. Anëtari i FBK-së mund të heqë dorë nga anëtarësia, duke bërë kërkesën me shkrim 6 muaj më parë dhe në fund të vitit financiar. Kërkesa përcillet në Kuvendin e radhës pasi që anëtari në dorëheqje t'i përmbushë të gjitha obligimet financiare ndaj FBK-së.

1.2. Anëtari i FBK-së përjashtohet nga Federata në rast të shkeljes së Statutit apo akteve tjera normative të Federatës. Vendimin preliminar për pezullimin e anëtarësisë së anëtarëve e merr Bordi i Federatës, ndërsa vendimin për përjashtimin e miraton Kuvendi i Federatës me vendim të më tepër se 50% të delegatëve të pranishëm në Kuvend.

1.3. Shkrirja e subjektit (ligjor) të një anëtarit mund të jetë vullnetare ose ligjore dhe humbë statusin e anëtarit edhe përpara arritjes së momentit të likuidimit.

1.4. Anëtarësia në Federatë konsiderohet e pezulluar për të gjitha klubet të cilat nuk marrin pjesë në garat e organizuara për stinorin aktual, apo të cilat nuk kanë marrë pjesë në gara përgjatë tërë stinorit paraprak në rastet kur mbledhja e Kuvendit mbahet gjatë pauzës në mes stinorëve. Anëtarësia konsiderohet e ndërprerë për të gjitha klubet që nuk marrin pjesë në dy sezona të njëpasnjëshme garuese.

2. Në rast të përfundimit të statusit të anëtarit, anëtari detyrohet të kthejë të gjitha asetet që i përkasin Federatës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në, burimet financiare, pajisjet sportive ose çdo pronë tjetër që mund të jetë dhënë nga Federata gjatë periudhës së anëtarësisë.

3. Federata do të angazhohet për ruajtjen e statusit të anëtarësisë brenda një periudhe të arsyeshme kohore që do të caktohet nga vetë FBK, përmes zhvillimit të diskutimeve të drejtpërdrejta ose, kur është e nevojshme, përmes ndërmjetësisë. Këto procese kanë për qëllim adresimin e



mosmarrëveshjeve ose shqetësimeve që ndikojnë në vazhdimësinë e anëtarësisë në mënyrë të drejtë dhe konstruktive.

NENI 10 - Fshirja nga anëtarësia

1. Në rast të ekzistimit të një prej shkaqeve të cekura në nenin 8 të kësaj Rregulloreje, Komisioni i Garave, në afat prej 30 ditësh nga dita e ndodhjes së shkakut, sipas detyrës zyrtare duhet të marrë aktvendim për fshirjen e ekipit nga anëtarësimi në FBK.

2. Komisioni i Garave i FBK-së, aktvendimin nga pika 9.1 ia dorëzon ekipit, Bordit të FBK-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së.

NENI 11 - Regjistri i klubeve anëtare të FBK-së

Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së nëpërmjet shërbimit administrativ udhëheq regjistrin e ekipeve anëtare të FBK-së dhe për çdo ekip udhëheq dosjen me dokumentacionin e tërësishëm nga momenti i regjistrimit të ekipit.

III. FUZIONIMI (BASHKIMI) I KLUBEVE

NENI 12 - Fuzionimi

1. Fuzionimi (bashkimi) i klubeve në garat e FBK-së është fuzionimi i dy e më tepër klubeve me marrëveshje për fuzionim në formë të shkruar, për realizimin e interesave të tyre dhe zhvillimin e sportit të basketbollit.

2. Gjatë kërkesës për fuzionim, ekipet janë të obliguara që në afatet e caktuara me këtë nen, t'i dorëzojnë Komisionit të Garave, Marrëveshjen origjinale për fuzionim me numër të mjaftuar të kopjeve (nga një për çdo ekip pjesëmarrës në fuzionim dhe një për FBK). Marrëveshja do të evidentohet në regjistrin e FBK-së ku dëshmohet pagesa e taksës administrative në shumë prej 500€.

3. Komisioni i Garave i FBK-së është i obliguar që në afat prej 3 (tri) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës të marrë lëndën në procedurë dhe e njëjta duhet të përfundojë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së lëndës në procedurë, përveç nëse natyra kërkon periudhë më të gjatë.

4. Marrëveshja për fuzionim në mes të dy apo më tepër klubeve të FBK-së merr efekt ligjor në momentin kur e njëjta lejohet me aktvendimin e Komisionit të Garave të FBK-së.



5. Nga momenti i fuzionimit të lejuar me aktvendimin e Komisionit të Garave, klubet e fuzionuara fillojnë të realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre në FBK si një ekip, gjegjësisht në harmoni me marrëveshjen reciproke për fuzionim. Nëpërmjet përfaqësuesit dhe nënshkruesit të autorizuar zgjidhet emri i ekipit, vula, llogaria bankare në Republikën e Kosovës, kontaktet, selia dhe adresa postare elektronike e ekipit dhe i njëjti në të ardhmen do të jetë përfaqësues pranë FBK-së.

6. Klubi, përfaqësues i klubeve të fuzionuara, në bazë të marrëveshjes për fuzionim, vazhdon të bëjë gara në një nga ligat e seniorëve, derisa klubet tjera, pjesëmarrës në fuzionim, mund të vazhdojnë veç e veç të garojnë në ligat e grupmoshave të reja të FBK-së si subjekte të veçanta ligjore. Klubet pjesëmarrëse në fuzionim nuk kanë të drejtë të garojnë në ligat e seniorëve derisa marrëveshja për fuzionim është në fuqi.

7. Në marrëveshjen për fuzionim duhet të jetë dispozita për mënyrën e ndarjes eventuale, ku në mënyrë precize duhet të ceket se cilat nga klubet dhe me çfarë statusi do të vazhdojnë pas ndarjes së krijuar, përgjegjësia financiare e subjekteve – të ardhurat nga anëtarësia, nga marketingu i ligave, dhuratat për plasman në ligat e FBK-së, etj., si dhe shpenzimet për gara, kootizime, dënime, licencime dhe shpenzime tjera në harmoni me Propozicione të Garave dhe akteve tjera, si dhe në bazë të vendimeve të trupave të autorizuar të FBK-së.

8. Fuzionimi mund të ketë veprim ligjor në sistemin e garave të FBK-së nëse kryhet më së voni 24 orë para paraqitjes së listës paraqitëse për garat e FBK-së për edicionin e ardhshëm të garave.

9. Fuzionimi pas këtij afati mund të ketë veprim ligjor në sistemin e garave të FBK-së nga edicioni tjetër.

IV. REGJISTRIMI I LOJTARËVE

NENI 13 - Parimet themelore

1. Të drejtat dhe obligimet gjatë regjistrimit, kalimit dhe paraqitjes së lojtarëve rregullohen në bazë të këtyre parimeve:

1.1. Lojtari zgjedh me dëshirë ekipin për të cilin do të paraqitet;

1.2. Lojtari mund të regjistrohet vetëm me një klub, me përjashtim të rasteve ku lojtari njëkohësisht regjistrohet edhe për një klub në basketbollin 3x3;



1.3. Marrëdhëniet në mes të lojtarit dhe klubit rregullohen me Marrëveshjen e lidhur në mes të lojtarit dhe ekipit;

1.4. Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes në mes të lojtarit dhe klubit, obligim i klubit është që ta njoftojë lojtarin me Statutin dhe aktet normative të FBK-së, si dhe me aktet dhe rregulloret e klubit;

1.5. Kur regjistrohet lojtari apo dorëzohet një kërkesë për kalim ose huazim për një lojtar nën moshën 18 vjeç, kërkohet pëlqimi i prindit ose përfaqësuesit ligjor;

1.6. Paraqitja e lojtarëve jashtë vendit dhe paraqitja e lojtarëve ndërkombëtarë (të huaj) në garat e FBK-së mund të kufizohet për t'u mbrojtur interesi i basketbollit kosovar;

1.7. Të gjitha të drejtat tjera rregullohen me këtë Rregullore dhe aktet e përgjithshme normative të FBK-së, kurse dispozitat e marrëveshjes nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me këtë Rregullore;

1.8. Gjatë regjistrimit të lojtarëve të të gjitha moshave, duhet të dorëzohet certifikata mjekësore e gjendjes shëndetësore të lojtarit dhe atë një herë brenda një edicionit, para fillimit të edicionit garues;

1.9. Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët të cilët janë të licencuar nga ana e organit të autorizuar nga FBK, me kusht që lojtari të ketë përmbushur të gjitha obligimet tjera dhe të mos jetë i suspenduar apo në vuajtje të dënimit.

NENI 14 - Regjistrimi

1. Lojtari me dëshirë e zgjedh klubin për të cilin do të paraqitet dhe me klubin e nënshkruan marrëveshje në të cilën e shpreh vullnetin e lirë për t'u regjistruar dhe paraqitur për ekipin, deklaron që do t'i pranojë aktet normative të ekipit, FBK-së, institucionit përkatës shtetëror, FIBA Evropa, FIBA, WADA dhe KosADA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe do të zotohet se do të respektojë principet e kodeksit të përgjithshëm sportiv.

2. Lojtari mund të regjistrohet më së shumti për dy (2) ekipe gjatë një edicioni garues.

3. Regjistrimi i lojtarit realizohet:

3.1. gjatë afateve kalimtare të përcaktuara me këtë Rregullore dhe me vendim të Bordit; dhe

3.2. jashtë afateve kalimtare vetëm në rastet e lejuara shprehimisht me këtë Rregullore.



4. Me regjistrimin në FBK, lojtarët japin pëlqimin që të filmohen dhe fotografohen gjatë garave, si dhe që të dhënat e tyre personale, përfshirë fotografitë dhe regjistrimet audio/vizuale, të përdoren për qëllime të mbarëvajtjes së garave, promovimit dhe masivizimit të basketbollit në Kosovë. Si rrjedhojë, FBK si organizatori kompetent i garës, ka të drejtën vullnetare, pa kompensim, jo-ekskluzive dhe të pakufizuar për t'i përdorur këto të dhëna ekskluzivisht për qëllimet e sipërpërmendura, përmes mediave dhe kanaleve të tjera mediatike, përfshirë web dhe online. Kjo përbën një interes legjitim të FBK-së si institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë.

5. Lojtari i cili nënshkruan marrëveshje me dy apo më tepër klube gjatë një afati kalimtar, do t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore dhe mbetet anëtar i klubit me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen e parë.

6. Lojtari i cili ka marrëveshje valide dhe nënshkruan marrëveshje me klub tjetër në afatin tjetër kalimtar, do të suspendohet dhe i njëjti nuk ka të drejtë paraqitjeje derisa të përcaktohet përgjegjësi disiplinore. Lojtari i tillë mbetet anëtar i klubit me të cilin ka marrëveshje valide, kurse marrëveshja e nënshkruar me klubin tjetër është e pavlefshme.

7. Lojtari i cili regjistrohet në FBK, prej atij momenti nuk ka të drejtë të paraqitet për klubin paraprak (ose ndonjë klub tjetër) në ndeshje zyrtare. Kjo vlen posaçërisht për afatet kalimtare dhe afatin kalimtar për lojtarë të huaj para fillimit të xhiros së XXII-të. Çdo paraqitje e verifikuar për klub tjetër pas regjistrimit në FBK do të rezultojë automatikisht me anulimin e regjistrimit të atij lojtari në FBK.

NENI 15 - Kërkesa për regjistrim të lojtarëve

1. Tarifat për regjistrimin e lojtarëve gjatë afatit kalimtar janë si në vijim:

- 1.1.** Superliga Meshkujt: 150 EUR;
- 1.2.** Superliga Femrat: 50 EUR;
- 1.3.** Liga e Parë Meshkujt: 50 EUR;
- 1.4.** Liga e Dytë Meshkujt: 50 EUR;
- 1.5.** Liga Zhvillimore U21 Vajzat: 50 EUR;
- 1.6.** Ligat e gjeneratave të reja: 20 EUR.



2. Për regjistrimin e parë të lojtarëve deri në moshën 14 vjeçare (të cilët për herë të parë regjistrohen në regjistrin e lojtarëve në FBK dhe regjistrimi i tyre bëhet gjatë tërë vitit) nevojiten:

- 2.1.** Formulari përkatës;
- 2.2.** Certifikata mjekësore (jo më të vjetër se një muaj);
- 2.3.** Fotokopja e pasaportës valide;
- 2.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se një (1) muaj;
- 2.5.** Dëshmia mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosë Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit.

3. Për regjistrimin e lojtarëve deri në moshën 18 vjeçare nevojiten:

- 3.1.** Formulari përkatës;
- 3.2.** Certifikata mjekësore (jo më të vjetër se një muaj);
- 3.3.** Fotokopja e pasaportës valide;
- 3.4.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se tre (3) muaj;
- 3.5.** Në rast se ka, marrëveshja për aftësim profesional të lidhur në mes të ekipit dhe prindit (kujdestarit) të lojtarit;
- 3.6.** Dëshmia mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit.

4. Për regjistrimin e lojtarëve senior (mbi moshën 18 vjeçare) nevojiten:

- 4.1.** Formulari përkatës;
- 4.2.** Marrëveshja e lidhur në mes të lojtarit dhe klubit;
- 4.3.** Certifikata mjekësore (jo më të vjetër se një muaj);
- 4.4.** Fotokopja e pasaportës valide;
- 4.5.** Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- 4.6.** Dëshmia mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit.

5. Për regjistrimin e lojtarëve të cilët kalojnë prej një klubi në klub tjetër nevojiten:

- 5.1.** Formulari përkatës;



5.2. Dëshmi për statusin kontraktual të lojtarit me klubin e mëparshëm, përmes njërës nga dokumentet në vijim:

5.2.1. marrëveshja e lojtarit me klubin e mëparshëm, afati i së cilës ka skaduar; apo

5.2.2. marrëveshja për ndërprerjen e ndër-sjell të Marrëveshjes me ekipin e mëparshëm; apo

5.2.3. vendimin e plotfuqishëm për ndërprerjen e Marrëveshjes të marr nga Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit.

5.3. Marrëveshja e lidhur në mes të lojtarit dhe klubit në të cilin kalon;

5.4. Certifikata mjekësore (jo më të vjetër se një muaj);

5.5. Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

5.6. Dëshmia mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit.

6. Për regjistrimin e lojtarëve të huaj për klubet e Republikës së Kosovës nevojiten:

6.1. Marrëveshja në mes të lojtarit dhe klubit;

6.2. Fotokopja e pasaportës së lojtarit;

6.3. Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

6.4. Certifikata mjekësore (jo më të vjetër se një muaj);

6.5. Fletë lëshimi (LOC) nga Federata Nacionale në të cilën lojtari është paraqit për herë të fundit;

6.6. Dëshmia mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit;

6.7. Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së.

7. Për regjistrimin e lojtarëve të lirë jashtë afatit kalimtar, e deri në përfundim të afatit kalimtar dimëror të edicionit përkatës, nevojiten:

7.1. Vendimi i plotfuqishëm nga Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit për përcaktim të statusit të lirë të lojtarit;

7.2. Marrëveshja në mes të lojtarit dhe klubit;

7.3. Fotokopja e pasaportës së lojtarit;

7.4. Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;



7.5. Certifikata mjekësore (jo më të vjetër se një muaj);

7.6. Dëshmia mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendos Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit.

8. Me nënshkrimin e personit të autorizuar, klubi konfirmon se lojtari ka dhënë informacion rreth vetes dhe ka nënshkruar personalisht formularin për regjistrim, dhe për një lojtar të mitur, se formulari është nënshkruar edhe nga përfaqësuesi ligjor ose kujdestari i lojtarit.

9. Për dhënien e informacionit ose dokumenteve të pasakta, klubi dhe lojtari mund të i nënshtrohen procedurave disiplinore.

10. Shërbimi administrativ mban evidencën e regjistrimit të lojtarëve me këto të dhëna:

10.1. Numrin rendor të regjistrimit;

10.2. Data e regjistrimit;

10.3. Emri dhe mbiemri;

10.4. Data dhe vendi i lindjes;

10.5. Numri personal dhe numri i pasaportës;

10.6. Adresa e vendbanimit;

10.7. Emri i klubit për të cilin regjistrohet lojtari.

11. Përveç të dhënave të detyrueshme nga paragrafi më sipër, të dhëna të tjera për lojtarin e regjistruar mund të futen për nevojat e përfaqësueseve të Kosovës, si gjatësia e lojtarit, numri i fanellës, numri i këpucëve dhe të dhëna të ngjashme.

NENI 16 - Procedura për regjistrimin e lojtarit ndërkombëtar (të huaj)

1. Çdo klub i cili ka të drejtë të regjistrojë lojtarë ndërkombëtarë (të huaj), së bashku me kërkesën për regjistrim është i obliguar që të dorëzojë dokumentacionin komplet më së voni 48 orë para ndeshjes kampionale apo të Kupës.

2. Procedura për sigurimin e Fletë lëshimit (LOC) bëhet nëpërmjet MAP -it të FIBA-s dhe FIBA Evropa në harmoni me rregullat dhe afatet e përcaktuara. Lojtari fiton të drejtën për paraqitje në ndeshje pas lëshimit të LOC-ut nga FIBA MAP dhe pas njoftimit të klubit nga FBK rreth kësaj.



V. PERIUDHA(T) KALIMTARE DHE KALIMI/TRANSFERI NGA KLUBI NË KLUB

Neni 17 - Afatet për kalim

1. Në përputhje me parimet themelore sipas kësaj rregullore që lojtari zgjedh klubin në të cilin dëshiron të luajë, përcaktohet një periudhë kalimtare gjatë së cilës lojtari mund të transferohet në një klub tjetër (afate kalimtare).
2. Transferimi i lojtarit mund të bëhet vetëm brenda periudhave/afateve zyrtare kalimtare të përcaktuara nga Bordi i FBK-së, përkatësisht:
 - 2.1. afati kalimtar veror;
 - 2.2. afati kalimtar dimëror.
3. Afati i paraqitjes së listës së lojtarëve për të gjitha kategoritë e seniorëve përcaktohet me vendimin e Bordit të FBK-së.

Neni 18 - Rastet kur lejohet kalimi/transferi

1. Të drejtë kalimi/transferi prej një klubi në klubin tjetër ka:
 - 1.1. lojtari të cilit i ka skaduar marrëveshja dhe nuk ka nënshkruar marrëveshje të re/rinovuar me klubin e deritanishëm;
 - 1.2. lojtari të cilit i ndërpritet marrëveshja në mënyrë të ndërsjellë (dyanshme);
 - 1.3. lojtari të cilit me anë të vendimit përfundimtar nga organi i shkallës së parë dhe/ose KAA i është përcaktuar statusi i lojtarit të lirë;
 - 1.4. lojtari i cili nuk gjendet në listën e lojtarëve të regjistruar të ekipit për edicionin përkatës mund transferohet më së voni një javë pas përfundimit të afatit të rregullt kalimtar;
 - 1.5. lojtari i ekipit që është përjashtuar nga garat apo i ka lëshuar garat për shkaqe të ndryshme gjatë edicionit aktual mund të kalojë prej klubi në klub në afat prej 10 ditësh nga dita e tërheqjes nga garat apo nga dita e përjashtimit të ekipit nga garat e mëtutjeshme. Në rastet e tilla, tek ekipet e kategorive e reja, lojtari mund të kalojë në klub tjetër deri në përfundim të afatit kalimtar dimëror.



Neni 19 - Transferimi i lojtarëve tek gjeneratat e reja

1. Për lojtarin deri në moshën 14 vjeçare, transferimi lejohet pa dëmshpërblim, përveç nëse ekziston marrëveshje e vlefshme për stërvitje dhe zhvillim.

2. Për lojtarin prej 14 deri 18 vjeç, i cili ka marrëveshjen për aftësim sportiv me ekipin e caktuar, transferimi lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

2.1. Nëse lojtari ka paguar në klub për aftësimin e tij sportiv dhe nëse për këtë dëshmon me dokumentacionin valid, ka të drejtë kalimi në klubin tjetër, pa dëmshpërblim dhe atë vetëm një herë gjatë një edicioni garues.

2.2. Nëse lojtari nuk i ka paguar klubit për aftësimin e tij sportiv, ka të drejtë kalimi në klubin tjetër me dëmshpërblim. Nëse me marrëveshje reciproke për aftësim sportiv nuk është cekur shuma për dëmshpërblim, atëherë do të paguhet sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 20 - Kompensimi/Dëmshpërblimi

1. Si rregull, nuk paguhet kompensim për transferimin e një lojtari nga një klub në një tjetër, përveç në rastin e kompensimit të përcaktuar nga një federatë sportive ndërkombëtare ose federatë sportive kombëtare, dhe në rastin e një transferimi kur lojtari tashmë ka një kontratë të vlefshme me klubin me një shumë të dakorduar kompensimi.

2. Përjashtim nga neni 1 është kompensimi i trajnimit, i cili paguhet vetëm një herë gjatë karrierës sportive të lojtarit, në rastin e transferimit të tij të parë nga një klub apo shkollë në një klub tjetër profesional para mbushjes së moshës 19 vjeç. Kompensimi i trajnimit ka për qëllim kompensimin e klubeve që kanë kontribuar në zhvillimin dhe aftësimin sportiv të lojtarit gjatë periudhës së trajnimit, gjegjësisht mosha 12-19 vjeç.

3. Kompensimi i trajnimit paguhet nga klubi i ri para regjistrimit të lojtarit dhe llogaritet sipas numrit të edicioneve sportive gjatë të cilave lojtari ka qenë i regjistruar në klubet trajnuese, si në vijim:

3.1. 300 EUR për çdo edicion sportiv në kategoritë U12-U14;

3.2. 500 EUR për çdo edicion sportiv në kategoritë U15-U16;

3.3. 800 EUR për çdo edicion sportiv në kategoritë U17-U18.



4. Në rast se lojtari ka qenë i regjistruar në më shumë se një klub gjatë periudhës së trajnimit, kompensimi ndahet proporcionalisht ndërmjet klubeve sipas numrit të sezoneve sportive të kaluara në secilin klub.
5. Nuk paguhet kompensim trajnimi për periudhën për të cilën klubi ka arkëtuar pagesa mujore të anëtarësisë ose trajnimit nga lojtari dhe për të cilën ekzistojnë dëshmi të pagesës. Në këto raste, kompensimi llogaritet vetëm për periudhën për të cilën nuk ekzistojnë dëshmi të pagesës.
6. Barra e provës për ekzistimin e pagesave mujore bie mbi lojtarin, prindin ose kujdestarin e tij ligjor, apo klubin e ri që pretendon zvogëlimin ose përjashtimin e kompensimit.
7. Pas pagesës së kompensimit të trajnimit sipas këtij neni, asnjë kompensim tjetër trajnimi nuk mund të kërkohej për transferimet e ardhshme të të njëjtit lojtar brenda sistemit të FBK-së.
8. Nuk paguhet kompensim trajnimi:
 - 8.1. për lojtarët që kanë mbushur moshën 19 vjeç;
 - 8.2. kur klubi ose klubet përfituese kanë hequr dorë me shkrim nga kompensimi;
 - 8.3. kur kompensimi i trajnimit është paguar më parë sipas këtij neni;
 - 8.4. në rastet kur rregulloret e FIBA-s ose të FBK-së përcaktojnë ndryshe.
9. Dëshmia për pagesën e kompensimit dorëzohet në zyrën e FBK-së para regjistrimit të lojtarit për klubin e ri.
10. Klubi përfitues mund të heqë dorë nga kompensimi me deklaratë të nënshkruar nga personi i autorizuar i klubit. Deklarata dorëzohet në zyrën e FBK-së.
11. Në rast mosmarrëveshjeje lidhur me ekzistimin e të drejtës në kompensim, shumën e kompensimit ose shpërndarjen e tij ndërmjet klubeve, vendos Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit.

NENI 21 - Procedura për kalim/transfer prej klubit në klub

1. Kërkesa për miratimin e transferimit të një lojtari nga një klub në tjetrin, së bashku me formularin e përcaktuar, duhet të dorëzohet nga klubi jo më vonë se dita e fundit e afatit kalimtar.



2. Lojtarët në kategoritë e gjeneratave të reja mund të transferohen nga një klub në tjetrin maksimumi një (1) herë në një edicion garues, me kusht që një transferim jashtë vendit të trajtohet si një transferim i vetëm.

3. Lojtari nuk mund të paraqitet në të njëjtën xhiro për dy skuadra.

4. Lojtarët e ligave të kategorive të reja të FBK-së, të cilët largohen nga listat paraqitëse të ekipit automatikisht marrin statusin e lojtarit të lirë me të drejtë kalimi në ekip tjetër pa dëmshpërblim, në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

VI. E DREJTA PËR LOJË - LICENCA

NENI 22 - Licenca

1. Licenca lëshohet pas verifikimit të përmbushjes së kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore, përfshirë dokumentacionin mjekësor dhe administrativ.

2. Licenca ka karakter të përkohshëm dhe lëshohet për një edicion garues ose për periudhën e caktuar me aktvendim të organit kompetent të FBK-së.

3. Lojtari nuk ka të drejtë të paraqitet në ndeshje zyrtare nëse:

3.1. nuk është i regjistruar në mënyrë të vlefshme në FBK;

3.2. nuk posedon licencë valide;

3.3. është i suspenduar apo në vuajtje të dënimit.

4. Lojtarët që janë të regjistruar dhe të licencuar për klubin në platformën përkatëse kanë të drejtë të luajnë në ndeshje zyrtare (kampionati dhe kupa).

5. Një lojtar mund të licencohet për një maksimum prej dy (2) klubesh në një edicion garues, pavarësisht nivelit të garës.

6. Vetëm një lojtar i aftë nga ana mjekësore mund të marrë licencë për të luajtur. Lojtari që regjistrohet pas fillimit të kampionatit nuk do të ketë të drejtë loje pa paraqitur kontrollin mjekësor.

VII. MARRËVESHJA/KONTRATA MES KLUBIT DHE LOJTARIT

NENI 23 - Marrëveshja ndërmjet klubit dhe lojtarit

1. Të drejtat dhe obligimet reciproke të lojtarit dhe klubit përcaktohen me Marrëveshje.

2. Të gjitha marrëveshjet ndërmjet klubit dhe lojtarit evidentohen në FBK. Pjesa e marrëveshjes që lidhet me kushtet financiare trajtohet si informacion konfidencial dhe këto të dhëna mund të përdoren vetëm nga organet



kompetente të FBK-së për qëllime të ushtrimit të kompetencave të tyre, në veçanti në procedura administrative, disiplinore dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Personat që kanë qasje në këto të dhëna janë të obliguar të ruajnë konfidencialitetin dhe nuk mund t'i zbulojnë ato palëve të treta, përveç në rastet e parashikuara me këtë Rregullore ose me ligjin në fuqi.

3. Kontrata në mes lojtarit dhe klubit lidhet në formë të shkruar, noterizohet dhe regjistrohet në Federatë. Përgjegjësia për deponimin dhe regjistrimin e kontratës në FBK bie ekskluzivisht mbi klubin. Për çdo kontratë të lidhur me lojtar që nuk është deponuar dhe regjistruar në FBK, klubi do të dënohet me gjobë në shumën prej 2,000.00EUR (dy mijë euro), pa cenuar vlefshmërinë e kontratës ndërmjet palëve dhe të drejtat e lojtarit që rrjedhin prej saj.

4. Në veçanti, kontrata duhet të përmbajë dispozita në lidhje me:

4.1. kohëzgjatjen e kontratës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vite dhe nuk parasheh periudhë provuese;

4.2. kushtet për rinovimin ose përfundimin e kontratës;

4.3. detyrimet financiare – pagesa e lojtarit dhe struktura e pagesave (p.sh. mujore, javore) si dhe shpërblime të tjera (p.sh., bonuse për arritje në gara të ndryshme, etj.). Paga mujore nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar me ligjin përkatës në Republikën e Kosovës. Shpërblimi për arritjen e rezultateve të larta sportive të klubit ose sportistit ose të ardhurat e tjera të përcaktuara me kontratë konsiderohen pjesë stimuluese mbi pagën bazë të cilën e pranon sportisti;

4.4. detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese – detyrimet dhe përgjegjësitë e lojtarit (p.sh., pjesëmarrja në ndeshje dhe stërvitje, sjellja profesionale, kodet dhe rregullat disiplinore që lojtari duhet të ndjekë dhe pasojat për shkelje disiplinore) dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e klubit (p.sh., sigurimi i pajisjeve, akomodimi, kujdesi shëndetësor);

4.5. kushtet për zgjidhjen e parakohshme të kontratës;

4.6. çdo dispozitë tjetër specifike që palët mund të bien dakord (p.sh., të drejtat e imazhit, pjesëmarrja në aktivitete promovuese, etj.);

4.7. nëse agjenti i lojtarit me licencë FIBA ka marrë pjesë në negocimin e kontratës, emri dhe numri i licencës duhet figurojë;



4.8. kontrata duhet të jetë e lidhur në përputhje me Statutin dhe aktet tjera normative të FBK-së, FIBA-s dhe rregulloret që vlejnë në Republikën e Kosovës.

5. Çdo marrëveshje plotësuese e nënshkruar në mes të lojtarit dhe klubit të njëjtë e cila nuk është evidentuar në FBK, e me të cilën marrëveshje apo pjesë të saj është përcaktuar angazhimi në sportin e basketbollit, do të ketë fuqi juridike dhe do të pranohet nga trupat e autorizuar të FBK-së dhe do të evidentohet me numër të njëjtë të protokollit si aneks i marrëveshjes paraprake.

6. Lojtari nën moshën 16 vjeç nuk mund të lidhë kontratë profesionale.

7. Kontrata e parë e pavarur mund të nënshkruhet nga klubi dhe lojtari kur lojtari të mbushë 16 vjeç, e cila mund të zgjasë vetëm derisa lojtari të mbushë moshën 18 vjeç.

8. Kontrata e parë profesionale mund të nënshkruhet nga klubi dhe lojtari kur lojtari të mbushë 18 vjeç. Një kontratë e tillë mund të zgjasë nga një deri në maksimum katër vjet, pra deri në fund të sezonit konkurrues në të cilin lojtari mbush 22 vjeç.

9. Deri në moshën njëzetë e pesë (25) vjeçare lojtari mund të lidhë marrëveshje për bursë sportive shkollare me klubin. Marrëveshja përfshin kompensimin për shpenzimet e nevojshme për shkollimin e sportistit dhe pjesëmarrjen në aktivitete sportive dhe pjesëmarrjen e lojtarit në aktivitetet e klubit që ofron bursën duke përfshirë trajnimin dhe garën e basketbollit.

10. Para fillimit të çdo edicioni garues, lojtarët nga të gjitha klubet duhet të marrin Rregulloren Disiplinore të klubit dhe të nënshkruajnë se e kanë marrë atë, përndryshe dënimet e vendosura ndaj lojtarëve nga klubet nuk do të merren parasysh gjatë zgjidhjes së problemeve/mosmarrëveshjeve të mundshme.

VIII. PARAQITJA JASHTË SHETIT

NENI 24 - E drejta e paraqitjes jashtë shtetit

Lojtari fiton të drejtën e paraqitjes jashtë vendit pas marrjes së pëlqimit nga klubi dhe lëshimit të fletë lëshimit (LoC) nga ana e FBK-së.

NENI 25 - Kërkesa

1. Kërkesa për dhënien e pëlqimit për paraqitje jashtë vendit dorëzohet nëpërmjet zyrës së FBK-së, ku dokumentacioni komplet duhet të përmbajë:



- 1.1.** Kërkesa nga Federata Nazionale të cilës i përket klubi, e adresuar në FBK;
- 1.2.** Pëlqimi i klubit për paraqitje jashtë vendit, nëse marrëveshja është valide;
- 1.3.** Pagesa e taksës administrative për fletëçregjistrim (LoC).

NENI 26 - Transferi ndërkombëtar i lojtarëve

- 1.** Transferi ndërkombëtar i lojtarëve deri në moshën 18 vjeçare nuk është i lejuar, përveç në raste speciale, në bazë të dispozitave të përcaktuara me aktet e FIBA-s dhe me këtë Rregullore.
- 2.** Për lojtarët më të vjetër se 18 vjeç, LoC për të luajtur jashtë vendit e lëshon personi i autorizuar në bazë të dispozitave të përcaktuara me aktet e FIBA dhe me këtë Rregullore.

X. PARAQITJA E LOJTARËVE NDËRKOMBËTARË (TË HUAJ)

NENI 27 - Paraqitja e lojtarëve të huaj

- 1.** Numri i paraqitjeve të lojtarëve ndërkombëtarë për të gjitha ligat dhe angazhimi i tyre në një ndeshje përcaktohet me Propozicione të Garave.
- 2.** Lojtarët e huaj të cilët janë të regjistruar në FBK dhe posedojnë LOC të vlefshëm për Kosovë, mund të transferohen ndërmjet klubeve vendore vetëm gjatë afateve kalimtare të përcaktuara nga FBK. Për regjistrimin e një lojtari të tillë, klubi i ri është i detyruar të paguajë një taksë fikse në shumën prej 2,000 EUR (dymijë euro). Lojtari i transferuar sipas këtij paragrafi nuk llogaritet në numrin e lojtarëve të huaj për të cilët kërkohet LOC sipas Propozicioneve të Garave të FBK-së.
- 3.** Lojtari ndërkombëtar deri në moshën 18 vjeçare i cili ka vendbanim në Republikën e Kosovës në bazë të shkollimit apo punës së përkohshme, mund të regjistrohet si lojtar vendor dhe të paraqitet për grupmosha të reja, me leje të Komesarit të Garave për Kategori të Reja në FBK.

NENI 28 - Lojtari i natyralizuar

- 1.** Për qëllim të kësaj Rregullore, bëhet dallimi mes lojtarit të natyralizuar përmes:
 - 1.1.** natyralizimit me Dekret të Presidentit për interes të veçantë të Republikës së Kosovës;



1.2. natyralizimit me mënyra të tjera (natyralizimi i bashkëshortit, natyralizimi i fëmijës së mitur të personit të natyralizuar, natyralizimi i pjesëtarit të diasporës të Republikës së Kosovës, natyralizimi i personit që e ka humbur shtetësinë e Republikën e Kosovës).

2. Lojtari i natyralizuar (sipas alinesë 1.1. apo 1.2. si më lart) ka të drejtë që për klub të regjistrohet si lojtar vendor, nëse klubi njofton për ndryshim të statusit të lojtarit deri në ditën e fundit të afatit kalimtar dimëror. Krahas njoftimit, duhet bashkëngjitur edhe dokumentet përkatëse (pasaporta kosovare apo letërnjoftimi i lëshuar nga institucionet e Kosovës dhe dekreti i Presidentit në rast të natyralizimit me Dekret të Presidentit për interes të veçantë të Republikës së Kosovës). Në rast se klubi nuk paraqet këtë njoftim, lojtari mban statusin e lojtarit të huaj deri në fund të edicionit garues.

3. Lojtarët e natyralizuar kanë statusin e lojtarit vendor deri në një vendim tjetër.

4. Duke filluar nga edicioni 2025/2026, lojtarët e natyralizuar duhet të kenë të paktën një paraqitje zyrtare me Përfaqësuesen e Kosovës.

XI. LICENCA E DYFISHTË DHE HUAZIMI

NENI 29 - Licenca e dyfishtë

1. Licenca e dyfishtë përbën një përjashtim nga parimi i një licence për një klub, duke i mundësuar lojtarit të regjistruar dhe të licencuar në një klub ("klubi amë"), të fitojë të drejtë paraqitjeje edhe për një klub tjetër ("klubi tjetër"), në një nivel më të ulët të garave, në përputhje me këtë rregullore.

2. Kërkesa për licencë të dyfishtë bëhet nga klubi tjetër me anë të formularit përkatës (*F7 - Formulari për licencë të dyfishtë*) dhe i drejtohet Komisionit të Garave. Kërkesa për licencë të dyfishtë mund të bëhet më së largu deri në përfundim të afatit kalimtar dimëror.

3. Licenca e dyfishtë mund të lëshohet për lojtarët deri në moshën 21 vjeç.

4. Licenca e dyfishtë lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet kumulative:

4.1. lojtari është i regjistruar dhe i licencuar në klubin amë;

4.2. klubi pritës garon në një nivel më të ulët garash se klubi amë;

4.3. ekziston pëlqimi paraprak, i shprehur me shkrim, i klubit amë;

4.4. lojtari nuk është subjekt i masave disiplinore që e ndalojnë paraqitjen.



- 5.** Lojtari me licencë të dyfishtë mbetet i regjistruar në klubin amë gjatë gjithë kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dyfishtë, ndërsa për klubin pritës fiton vetëm të drejtë të kufizuar paraqitjeje, pa ndryshuar statusin e tij të regjistrimit.
- 6.** Licenca e dyfishtë lëshohet nga organi kompetent i Federatës dhe vlen për një edicion garues, përveç nëse revokohet ose skadon më herët sipas kësaj rregulloreje.
- 7.** Në rast se lojtari me licencë të dyfishtë paraqitet për të luajtur për dy ekipe në ditën e njëjtë të zhvillimit të ndeshjeve, kjo përgjegjësi bie te klubi amë i cili vendosë për paraqitje apo mos paraqitje të lojtarit në dy ndeshje brenda ditës.
- 8.** Në Ligën e Parë dhe Ligën e Dytë (meshkujt), një klub mund të ketë të regjistruar jo më shumë se katër (4) lojtarë me licencë të dyfishtë gjatë një edicioni garues.
- 9.** Në Ligën Zhvillimore U21 Vajzat, një klub mund të ketë jo më shumë se dy (2) lojtare me licencë të dyfishtë.

NENI 30 - Huazimi i lojtarëve

- 1.** Një klub mund të huazojë një lojtar të një klubi tjetër për një edicion garues, me ç'rast lojtari nuk ka më të drejtën të paraqitet për klubin në të cilin është regjistruar, mirëpo fiton të drejtën për të luajtur për klubin në të cilin është huazuar.
- 2.** Huazimi është i mundur vetëm përmes marrëveshjes me shkrim për huazim dhe mund të arrihet vetëm para përfundimit të afatit kalimtar.
- 3.** Kërkesa për huazim bëhet nga klubi në të cilin lojtari është huazuar dhe bëhet përmes formularit përkatës (*F11 - Formulari për huazim të lojtarit*) duke iu drejtuar Komisionit të Garave.
- 4.** Në rast të huazimit të një lojtari nën moshën 18 vjeç, duhet bashkëngjitet pëlqimi me nënshkrim të prindit ose përfaqësuesit ligjor.
- 5.** Një klub mund të ketë maksimum 2 lojtarë të huazuar në konkurrencën e meshkujve dhe 5 lojtare të huazuara në konkurrencën e femrave.



XII. MEKANIZMAT LIGJOR BRENDA FEDERATËS

NENI 31 - Procedura për përcaktimin e statusit të lojtarit të lirë

- 1.** Në rast shkeljeje të dispozitave thelbësore të kontratës që lidhen me përmbushjen e detyrimeve të klubit, si p.sh. pagesat për lojtarët, lojtari duhet të kërkojë nga Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (KAA), të kryejë një procedurë për përcaktimin e statusit të lojtarit të lirë.
- 2.** Para paraqitjes së kërkesës për përcaktimin e statusit të lojtarit të lirë, lojtari është i detyruar t'i dërgojë klubit një njoftim me shkrim, duke i kërkuar përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të papaguara dhe duke i lënë afat prej dhjetë (10) ditësh nga data e pranimit të njoftimit për t'i përmbushur ato. Nëse klubi nuk i përmbush detyrimet brenda afatit të caktuar, lojtari ka të drejtë të paraqesë kërkesë pranë KAA-së.
- 3.** Kërkesat për përcaktimin e statusit të lojtarit të lirë mund të paraqiten deri në fillimin e afatit kalimtar dimëror të edicionit përkatës. Për paraqitjen e kërkesës paguhet tarifë procedurale në shumën prej 100 EUR.
- 4.** Pas pranimit të kërkesës, KAA do të kryejë një verifikim paraprak të pretendimeve dhe provave të paraqitura brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga data e pranimit të kërkesës.
- 5.** Nëse gjatë verifikimit paraprak KAA konstaton se kërkesa është paraqitur me qëllim mashtrimi ose me vetëdije mbi fakte apo prova të rreme, kërkesa do të refuzohet dhe lojtarit do t'i shqiptohet gjobë në shumën prej 10,000.00EUR (dhjetë mijë euro).
- 6.** Me vendim të KAA që konstaton se kontrata midis klubit dhe lojtarit është ndërprerë për shkak të mos përmbushjes ose shkeljes së dispozitave thelbësore të kontratës nga klubi, lojtarit i njihet statusi i lojtarit të lirë, i cili mund t'i bashkohet një klubi tjetër pa kompensim.
- 7.** Në të njëjtin vendim, KAA do të përcaktojë detyrimin total të klubit ndaj lojtarit, dhe nëse klubi nuk e përmbush detyrimin ndaj lojtarit brenda afatit të caktuar, klubi nuk do të mund të regjistrojë lojtarë të ri deri në zbatim. Klubi mund të regjistrojë vetëm lojtarë në kategoritë e moshave të reja dhe t'i licencojë për garat e kategorive të moshave të reja.
- 8.** Nëse kërkesa e lojtarit aprovohet, klubi është i detyruar të ri-mbursojë lojtarin për shpenzimet e procedurës (tarifa).



9. Nëse, pavarësisht masave nga paragrafët e këtij neni, detyrimet kontraktuale nuk mund të përmbushen, KAA do ta referojë lojtarin në mekanizmat ligjorë jashtë Federatës, me qëllim realizimin e kërkesave të tij.

NENI 32 - Procedura për mbrojtje të kontratës

1. Mbrojtja e kontratës sipas këtij neni nënkupton miratimin e një vendimi, me të cilin klubi angazhohet të paguajë kërkesat financiare të lojtarit apo trajnerit nga edicioni i fundit garues.

2. Kërkesat për mbrojtjen e një kontrate pranohen në periudhën nga 01.07 deri me 31.07 të çdo viti. Për paraqitjen e kërkesës paguhet tarifë procedurale në shumën prej 100 EUR.

3. Nëse KAA vlerëson se kërkesa e lojtarit/trajnerit është e bazuar, para marrjes së vendimit për miratimin e Kërkesës për Mbrojtjen e Kontratës, do të caktohet një afat prej dhjetë (10) ditësh për klubin që të përmbushë detyrimin e tij.

4. Nëse klubi nuk e përmbush detyrimin ndaj lojtarit/trajnerit brenda afatit të caktuar, KAA do të marrë vendim për miratimin e Kërkesës për Mbrojtjen e Kontratës dhe atë brenda pesë (5) ditëve nga skadimi i afatit për klubin.

5. Në rast të mos-pagimit ndaj lojtarit/trajnerit pas vendimit përfundimtar mbi miratimin e Kërkesës për Mbrojtjen e Kontratës, klubi nuk do të mund të regjistrojë lojtarë të ri deri sa të zbatohet vendimi përfundimtar. Klubi mund të regjistrojë vetëm lojtarë në kategoritë e moshave të reja dhe t'i licencojë për garat e kategorive të moshave të reja.

6. Nëse Kërkesa e lojtarit/trajnerit aprovohet, klubi është i detyruar të rimbursojë lojtarin për shpenzimet e procedurës (tarifa).

7. Nëse, pavarësisht masave nga paragrafët e këtij neni, detyrimet kontraktuale nuk mund të përmbushen, KAA do ta referojë lojtarin në mekanizmat ligjorë jashtë Federatës, me qëllim realizimin e kërkesave të tij.

NENI 33 - Procedura për zgjidhjen e mos-marrëveshjeve mes klubeve

1. Në rast të një mosmarrëveshjeje mes klubeve që lind nga transferimi i një lojtari nga një klub te një tjetër, ose nga kompensimi për transferimin e një lojtari, pala e interesuar dorëzon një kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes tek KAA.



- 2.** Mosmarrëveshja për të cilën dorëzohet kërkesa mund të datojë nga edicioni që sapo ka përfunduar ose, më së voni, nga edicioni që i ka paraprirë atij që sapo ka përfunduar. Për paraqitjen e kërkesës paguhet tarifë procedurale në shumën prej 500 EUR.
- 3.** Pas pranimit të kërkesës, KAA kërkon deklaratë zyrtare nga pala tjetër e mosmarrëveshjes, e cila është e detyruar të përgjigjet brenda 10 ditëve, duke dorëzuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të mbështetur pretendimet e saj. Në rast se pala kundërshtuese nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se nuk i kundërshton pretendimet e parashtuara në kërkesë. KAA do të marrë vendim brenda pesë (5) ditëve nga skadimi i afatit për përgjigje ose nga pranimi i përgjigjes dhe dokumentacionit përkatës.
- 4.** Në rast të moszbatimit të vendimit përfundimtar të KAA, do të refuzohet regjistrimi i lojtarëve të ri për klubin që nuk e zbatoi vendimin përfundimtar. Klubi mund të regjistrojë vetëm lojtarë në kategoritë e moshave të reja dhe t'i licencojë për garat e kategorive të moshave të reja.
- 5.** Në rast se kërkesa aprovohet, pala kundërshtuese është e detyruar të rimbursojë aplikantin për shpenzimet e procedurës (tarifa).

NENI 34 - Ankesa në vendimet e Komisionit të Garave

- 1.** Kundër vendimit të Komisionit të Garave të FBK-së, të publikuar në faqen zyrtare të FBK-së, palët në afat prej 3 ditësh nga dita e publikimit apo nga dita e pranimit të vendimit, kanë të drejtë ankesë nëpërmjet Komisionit të Garave tek Komisioni i Ankesave dhe i Arbitrazhit të FBK-së (si shkallë e dytë).
- 2.** Ankesa e cila është dorëzuar pas afatit të caktuar për ankesë do të refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.
- 3.** Nëse kundër vendimit të Komisionit të Garave të FBK-së, një nga palët ka paraqit ankesë, regjistrimi dhe paraqitja e lojtarit nuk është i lejuar deri në vendimin e marr nga Komisioni i Ankesave dhe i Arbitrazhit i FBK-së.
- 4.** Komisioni i Ankesave dhe i Arbitrazhit është i obliguar që në afat prej shtatë (7) ditësh të marrë ankesën në shqyrtim.
- 5.** Nëse palët nuk kanë shfrytëzuar të drejtën e ankesës, palët kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e ligjshmërisë e cila dorëzohet nëpërmjet të Komisionit të Garave tek Bordit i FBK-së.



6. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka efekt pezullues në vendimin e plotfuqishëm të Komisionit të Garave dhe vendimi i marr sipas kërkesës nuk ka efekt retroaktiv në lidhje me ndeshjet të cilat janë zhvilluar deri në marrjen e saj.

7. FBK nuk merr përgjegjësi për kurrfarë kompensimi të dëmeve të shkaktuara për anulimin e vendimit të shkallës së parë.

8. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për vendimet e Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së, të cilat janë përfundimtare.

XIII. DORËZIMI

NENI 35

1. Korrespondencën me FBK-në dhe komisionet e FBK-së palët e kryejnë nëpërmjet zyrës ekzekutive të FBK-së.

2. Dorëzimi i shkresave në FBK kryhet drejtpërdrejtë në zyrën e FBK-së, me anë të postës elektronike dhe/apo me anë të postës.

3. Çdo shkresë e dorëzuar nga personi juridik në FBK duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar apo nëpërmjet të autorizuesit me autorizimin e bërë nga noteri.

4. Data e pranimit të shkresës konsiderohet dita kur shkresa është pranuar me anë të postës elektronike dhe/apo me anë të postës.

5. Zyra Administrative e FBK-së, shkresat e dorëzuara i adreson në palët e cekura në adresë.

XIV. AFATET

NENI 36

1. Nëse afatet janë caktuar me ditë, në afat nuk llogaritet dita e dorëzimit të shkresës.

2. Brenda afatit të përcaktuar, do të konsiderohet dita e parë e ardhshme.

3. Në afat të përcaktuar nuk llogaritet dita e diel dhe festat shtetërore dhe afati kalon pas kalimit të ditës së parë të ardhshme punuese.



XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALUESE

NENI 37

1. Të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë rregullore, do të përcaktohen me Propozicionet e Garave, aktet normative të FBK-së dhe ato të FIBA-s.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje miratohen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të tyre.
3. Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep Bordi i FBK-së.
4. Kjo Rregullore hynë në fuqi me miratimin e saj nga ana e Bordit të FBK-së.

Miratoi Bordi i FBK-së më 30.07.2026 në Prishtinë.

Në emër të Bordit të FBK-së,
Kryetar

Arben FETAHU

